

Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”

1. Anëtarët e komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” (KGSHD), në nivel njësie kryesore përzgjidhen nga asambleja e personelit akademik të fakultetit pas një procesi vetëkandidimi. Ata janë personel akademik me kohë të plotë të kategorisë “Profesor”. Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
2. KGSHD ngrihet mbi bazën e njësisë kryesore të UBT-së që ofron programe të ciklit të tretë.
3. Numri i anëtarëve të KGSHD në UBT është pesë ose shtatë anëtarë.
4. Funksionimi i KGSHD në UBT përcaktohet në rregulloren e UBT-së dhe në rregulloren e njësisë kryesore, të cilat miratohen nga Senati Akademik.

Komisionet e Përhershme

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjinale, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara sipas këtij Statuti, që lidhen kryesisht me:
 - a. kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik,
 - b. garantimin e standardeve të cilësisë të universitetit dhe programeve të studimit,
 - c. me mbarëvajtjen e veprimtarisë së universitetit dhe marrëdhëniet me studentët.
2. Komisionet e përhershme përbëhen prej pesë/shtatë anëtarë dhe krijohen në nivel universitetit dhe në nivel fakulteti.
3. Anëtarët e komisioneve të përhershme të universitetit vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Anëtarët e komisioneve të përhershme të fakultetit vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të fakultetit midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
5. Pranë UBT_së organizohen dhe funksionojnë Komisionet e Përhershme si më poshtë:
 - **Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor**
 - **Komisioni për promovimin e Personelit Akademik**
6. Pranë fakulteteve të UBT_së organizohen dhe funksionojnë Komisionet e Përhershme si më poshtë:
 - **Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor**
 - **Komisioni për dhënien e Gradës Shkencore**
7. Në përbërje të komisioneve të përhershme përfaqësohen dhe studentët, me përjashtim të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” dhe Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.
8. Anëtarët e komisionit të përhershëm, që monitorojnë procesin për dhënien e gradës shkencore, përzgjidhen nga asambleja e personelit akademik të fakultetit, pas një procesi vetëkandidimi. Ata mbajnë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

9. Anëtarët e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, (për dhënien e titujve akademikë “Profesor” dhe “Profesor i asociuar”), përzgjidhen nga Senati Akademik nga personeli akademik i fakulteteve, pas një procesi vetëkandidimi. Ata mbajnë titullin “Profesor”. Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
10. Anëtarët e komisioneve të tjera në nivel fakulteti, sipas pikës 6 të këtij neni, përzgjidhen nga asambleja e personelit akademik (për numrin e anëtarëve nga ky personel) dhe asambleja e studentëve të tij (për anëtarin nga kjo asamble), pas një procesi vetëkandidimi.
11. Anëtarët e komisioneve të tjera në nivel Universiteti (nga personeli akademik dhe studentë), sipas pikës 5 të këtij neni, përzgjidhen nga Senati Akademik, pas një procesi vetëkandidimi.
12. Kompetencat dhe sfera e veprimtarisë së këtyre Komisioneve përcaktohen në Rregulloren e çdo Komisioni;

